



Npi – 01/180 datë: 29.05.2024

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), si dhe Nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenin 5 dhe nenin 10, paragrafin 2, të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet me numër, Npi – 01/173, të datës 27.05.2009; Si dhe duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" me numër Npi-01/76 të datës 26.02.2024, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 29.05.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E ÇMIMIT "NDERI I QYTETIT" TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -V- për vitin 2024 të mbajtur më 29.05.2024, unanimisht miratoi vendimin për ndarjen e Çmimit "Nderi i Qytetit", të Komunës së Shtimes, për grupin e plejadës të doktorëve të suksesshëm, që e avansuan shëndetësinë e Komunës së Shtimes në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, si vijon:

1. Dr.Rifat Bajrami – Carralevë,
2. Dr.Hysni Arifi – Belinc,
3. Dr.Sami Salihu – Mollopolc,
4. Dr.Isa Haxhiu – Rashincë,
5. Dr.Vezir Bajrami – Reçak, (Post mortum)

II

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës së Shtimes, duke u bazuar në kompetencat e veta në bazë të kornizës ligjore të përshkruar më lartë, dhe pas diskutimeve lidhur me historikun e 5 Doktorëve të suksesshëm për Komunën e Shtimes, ka vendosur të u ndajë çmimin "Nderi i Qytetit" të Komunës së Shtimes, sipas dispozitivit të këtijë Vendimi. Kuvendi ka marrë parasysh edhe Rekomandimin Npi-01/171 dt.27.05.2024, të Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe Rekomandimin Npi-01/167 dt.23.05.2024 të Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" të Komunës së Shtimes.

Për anëtarët e Kuvendit të gjithë kanë qenë dhe janë, personalitete të spikatura të njohur si Doktor, Profesor Univerziteti, Menaxherë Klinikash Univerzitare, Kontribues në fushën e shkencës të mjekësisë, që kanë kontribuar shumë në veçanti për shëndetësinë e Komunës së Shtimes, e në përgjithësi, në rrafshin kombëtar për edukimin e brezit të ri të mjekëve, po ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar me punime shkencore e studimore në fushën e shëndetësisë.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryetari i Kuvendit
Adnan Ademi